



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
KOMISIONI I SISTEMIT DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__. 2024

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Adresa “Rruga e Kavajës”, Nr. 1001, Tiranë
Tel/Fax 003553364622
Adresa e Internetit www.shendetesia.gov.al
Personi Përgjegjës: bledar.taushani@shendetesia.gov.al

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me sistemin e thjeshtuar dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt:

“Blerje e 5 (pesë) biletave udhëtimi me avion, vajtje-ardhje, Tiranë – Bruksel – Tiranë:”.

Data e zhvillimit të prokurimit me sistemin dinamik të blerjeve do të jetë 15/03/2024 ora e hapjes së ofertave është 11:00 në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia
1	<u>Blerje e 5 (pesë) biletave udhëtimi me avion, vajtje-ardhje, Tiranë – Bruksel – Tiranë:</u> Nisja nga Tirana për në Bruksel do të bëhet më datë 19 mars 2024, (ora 06:20) dhe kthimi nga Bruksel për në Tiranë do të bëhet në datën 22 mars 2024 (ora 09:40).	5	Copë

Kriteret e veçanta të kualifikimit:

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, **duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:**

- 1- Operatori Ekonomik duhet të ketë të vlefshme certifikatën e akreditimit nga IATA (International Air Transport Association) të vlefshme për vitin 2024.
- 2- Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 2 punonjës (që të rezultojnë në listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar).
- 3- Operatori ekonomik duhet të disponojë licence për Agjenci Udhëtimi lëshuar nga QKB.
- 4- Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar me bagazhe të përfshira, me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit.
- 5- Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e itinerarit.

- Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të marrë kontakte menjëherë me AK, pas mbylljes së vlerësimit (në sistemin e APP menjëherë pas mesazheve) dhe duhet të konfirmojë shërbimin brenda 2 orëve nga marrja e njoftimit.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Çdo kriter i mësipërm, i cili nuk plotësohet, përbën kusht për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Maksimumi me një tranzit, Klasi ekonomik.
- OE të realizojë check in online në vajtje dhe në kthim.
- Operatori ekonomik duhet të përfshijë në çmim edhe bagazhet.
- Shpenzimet e transportit përfshijnë udhëtimin me avion Tiranë – Bruksel - Tiranë për 5 (pesë) persona të rritur.

Operatori ekonomik me anë të një vetëdeklarimi, duhet të marrë përsipër se:

- Do të jetë në gatishmëri për kryerjen me sukses të shërbimit të biletarisë.
- Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.
- Të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit, përsa i takon informacionit të siguruar nga Autoriteti Kontraktor.
- Të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.

Afati i dorëzimit të dokumenteve: Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues **në zyrën e protokollit të MSHMS-së**, sipas kërkesave të mësipërme **brenda 2 (dy) orëve** nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit

Elektronik (SPE). Në të kundërt, do të bëhet kalimi te ofertuesi i radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit e mbetur në klasifikim.

- Në rast tërheqje nga oferta, operatori ekonomik duhet të njoftoj Autoritetin Kontraktor.
- Kriteri vlerësimit do të jetë çmimi më i ulët.

Shënim: Operatori ekonomik i shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të ketë:

- *Kopje të certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të faturave.*
- *Kopje të certifikatës elektronike për Fiskalizimin, dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.*

Sqarojmë se:

Nëse pas verifikimit në faqen zyrtare të QKB-së ndonjë nga operatorët ekonomik nuk kanë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, janë tërhequr nga realizimi i objektit të prokurimit pa njoftuar brenda afatit apo kanë pasur eksperiencë të mëparshme të përealizuara me sukses me Autoritetin Kontraktor do të s'kualifikohen automatikisht nga komisioni i sistemit dinamik të blerjeve të biletave.

Afati i përfundimit të blerjes së biletës me itineraret e kërkuara do të jetë data 15.03.2024.

TITULLARI I AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR/OSE PERSONI I AUTORIZUAR

Suzana Hoxha